



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ**

**NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN**

**DREJTUAR BANORËVE TË BASHKISË KAMËZ DHE TË GJITHË PALËVE TË  
INTERESUARA.**

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “ Për njoftimin dhe konsultimin publik” në nenin 9, pika 1, 3 , të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 18, në rregulloren e Këshillit Bashkiak, për konsultimin publik”.

Ju njoftojmë se konsultim publik do të zhvillohet mbi këto tema:

- ❖ **INFORMIM I QYTETARËVE PËR BUXHETIN E VITIT 2025**
- ❖ **PLANIFIKIM I BUXHETIT PËR VITIN 2026**

**Drejton dëgjuesën:** Kryetari i Bashkisë Kamëz, z.Rakip Suli.

Ftojme të gjithë grupet e interesit si: banorë të Bashkisë Kamëz , administratorët e njësive dhe lagjeve administrative të Bashkisë Kamëz, ndërlidhës të lagjeve administrative, biznese, grupet e marginalizuara, të rinj/ të reja, shoqërinë civile, etj., të bëhen pjesë e kësaj dëgjese për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Konsultimi publik do të zhvillohet sipas kalendarit të mëposhtëm:

**Datë: 24/10/ 2025**

**Ora: 16:00**

**Vendi: Pallati i Kulturës “Artan Cuku”**

Ky takim ka si qëllim kryesor bashkëpunimin dhe mbledhjen e rekomandimeve, të cilat do të shërbejnë për planifikimin e buxhetit për vitin 2026.

Mirëpresim rekomandime, propozime dhe sugjerime konkrete, të cilat mund të dërgohen në adresën e mëposhtme të e-mailit:

-[konsultim.publik@kamza.gov.al](mailto:konsultim.publik@kamza.gov.al) Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Kjo dëgjese do të zhvillohet në bashkëpunim me Bashkinë, Njësitë dhe Lagjet Administrative të Bashkisë Kamëz, Anëtarë/përfaqësues të Këshillit Bashkiak Kamëz.

Jeni të lutur të merrni pjesë, pasi pjesëmarrja juaj është shumë e rëndësishme.